

VENDIM
Nr.235, datë 3.10.2011

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN PRIVAT VENDOR “TV ADRIA MED”
SUBJEKTIT: SHOQËRIA “ADRIA MED” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, dhe rregullores “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010 të KKRT-së, pasi mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “Adria Med” sh.p.k. për t’u licencuar si operator televiziv privat vendor dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë shoqërisë “Adria Med” sh.p.k., licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat vendor, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për të mbuluar me sinjal rrethin e Durrësit.
 2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati